



## KONTRATË

Numri i kontratës: KM653-24-1149-5-2-1/C535

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLICA KOSOVA	
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTARËVE CENTAR ZA USLUGU GRADANA	
Sh. U. 02	Nr. Br. 9630
Nr. ifaq. 23	Data: 27/03
Br. str. KAMENICË/A	Datum: 2024

KOMUNA E KAMENICËS, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërin anë, dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik NIKA Pro- Ing SLLP.K.; Pro & Co Group Ferizaj, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

**Participimi me donatore-Ndërtimi i Lugut të Verdhë** me numër identifikues: KM653-24-1149-5-2-1

### Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **Participimi me donatore-Ndërtimi i Lugut të Verdhë**

No.	Lot
1	Participimi me donatore-Ndërtimi i Lugut të Verdhë

### Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **197,000.10 €: Njëqindenedhjetëeshtatë mijë Euro e 10 cent.**

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

### Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

### Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin

1. Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetimin të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetimin të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

<b>Emri:</b>	Urim Thaqi
<b>Pozita:</b>	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	27.03.2024
<b>Vula:</b>	

Për Kontraktuesin

<b>Emri:</b>	Korab Ferizi
<b>Pozita:</b>	Person i autorizuar
<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	27.03.2024
<b>Vula:</b>	

# KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: KM653-24-1149-5-2-1/C535

## Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorpuar me referencë në të.

1.2 "Punë" konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 "Kontraktuesi" është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 "Menaxheri i Projektit" është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës ( apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 "Çmimi Kontratës" do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 "Vendi i ndërtimit" do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 "Pajisjet e kontraktuesit" do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 "Skicat" nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruar dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

## Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

## Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.



#### **Neni 4 Nën-kontraktimi**

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktonte pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njej lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkritazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

#### **OBLIGIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES**

##### **Neni 5 Dhënia e dokumenteve**

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë në dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet ti kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

##### **Neni 6 Qasja në vend punishte**

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do ti jap qasje dhe akses Kontraktuesit në vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjatë shfrytëzimit, duhet të mirëmbaje çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, ti kthej ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

##### **Neni 7 Ndhurma lidhur me rregulloret vendore**

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.



7.2 Në bazë të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejen e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsideron të nevojshme, si dhe lejet e qëndrimit për familjet e tyre.

## **OBLIGIMET E KONTRAKTUESIT**

### **Neni 8 Obligimet e Kontraktuesit**

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalojë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 12.

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritet nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

8.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktivitetëve në vend punim.

### **Neni 9 Personeli**

9.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuar në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

### **Neni 10 Siguria e ekzekutimit**

10.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Pranimit të Përkohshëm.

10.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

## **Neni 11 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit**

11.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

11.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuar.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbresë çmimin e shpërbllimit nga fitimi i kontraktuesit.

## **Neni 12 Programi**

12.1 Brenda kohës se specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë se paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatohen, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

12.2 Nëse menaxheri i projektit për më tepër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnoj Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

12.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

12.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëloj ose të rris detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

## **Neni 13 Siguria në vend punishte**

13.1 Kontraktuesi do të ketë të drejtën të ndaloj qasjen në vend-punishte për çdo person i cili nuk është i përfshirë në zbatimin e kontratës, me përjashtim të personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.

13.2 Kontraktuesi do të sigurojë sigurinë në vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e nevojshëm, në interes të punonjësve të tij, agjentëve të Autoritetit Kontraktues dhe palëve të treta, për të parandaluar çdo humbje ose aksident i cili mund të rezultojë nga kryerja e punëve.

13.3 Kontraktuesi do të marrë të gjitha hapat e domosdoshme, për përgjegjësinë e tij dhe me shpenzimet e tij, për të siguruar që strukturat dhe instalimet ekzistuese mbrohen, ruhen dhe mirëmbahen. Ai do të jetë përgjegjës për sigurimin, me shpenzimet e tij, ndriçimin, sigurinë, skermën dhe pajisjet e sigurisë të cilat janë të nevojshme për zbatimin e duhur të detyrave ose që me arsye mund të kërkohen nga Autoriteti Kontraktues.

## **Neni 14 Ndërhyrja me trafikun**

14.1 Kontraktuesi do të sigurojë që punimet dhe instalimet nuk shkaktojnë dëme, ose pengojnë trafikun në, lidhjet e komunikimit të tilla si rrugët, hekurudhat, rruge ujore dhe aeroporte. Ai, në veçanti, do të marrë parasysh kufizimet në peshë kur zgjedh rrugët dhe automjetet.



14.2 Çdo masë të veçantë të cilën Kontraktuesi e konsideron të nevojshme, ose është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të mbrojtjes apo për të përfunduar pjesët e rrugëve, urave, do të bartet në shpenzime të Kontraktuesit, pa marrë parasysh se ato kryhen nuk ato kryhen nga Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin kontraktues për çfarëdo masa të veçanta që ai synon të ndërmarrë para se kryej ato. Riparimet e dëmit të shkaktuara në rrugë, ura nga transporti i materialeve apo pajisjeve do të jetë në shpenzime të Kontraktuesit.

#### **Neni 15 Tatimi**

15.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

15.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

15.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

15.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

#### **Neni 16 Kostoja e Riparimeve**

16.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

### **FILLIMI DHE VONESAT**

#### **Neni 17 Fillimi i punëve**

17.1 Kontraktuesi do të filloj punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

17.2 Kontraktuesi do të ndërtoj dhe instaloj Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësoj ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

#### **Neni 18 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit**

18.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 38;

18.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

18.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit të detajeve sipas Nenit 18.2 Autoriteti Kontraktues do të lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

#### **Neni 19 Dëmet e likuiduara**

19.1 Kontraktuesi do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Kontraktuesit.

19.2 Nëse Autoriteti Kontraktues ka fituar të drejtën e vlerës maksimale në bazë të nenit 19.1 ai mundet, pasi ta njoftojë Kontraktuesin:

- (a) konfiskojë garancinë e realizimit; dhe / ose
- (b) të ndërpresë kontratën; dhe
- (c) të hyjë në një kontratë me një palë të tretë në koston e Kontraktuesit për ofrimin e bilancit të punimeve.

## **MATERIALET DHE MJESHTRITË**

### **Neni 20 Regjistri i punës**

20.1 Një regjistër i punës do të, përveç kur parashikohet ndryshe nga KVK, mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit, i cili do të mbaje të paktën informacionin e mëposhtëm:

kushtet e motit, ndërprerjet e punës që detyrohen nga moti me shi, orët e punës, numrin dhe llojin e punëtorëve të punësuar në vend-punishte, materialet e furnizuara, pajisjet në përdorim, pajisjet jo në gjendje pune, testet e kryera në vend, mostrat e dërguara, rrethanat e paparashikuara si dhe urdhrat dhëne Kontraktuesit;

deklaratat e hollësishme të të gjitha elementeve sasiore dhe cilësore të punës së bërë dhe furnizimet e dorëzuara dhe të përdorura, të afta për tu kontrolluar në vend-punishte dhe të rëndësishme në llogaritjen e pagesave që duhet bërë Kontraktuesit.

20.2 Shënimet e bëra në regjistrin e punës, si pune në progres, duhet të nënshkruhen nga Autoriteti Kontraktues dhe të bashkë-nënshkruhen nga Kontraktuesi ose përfaqësuesi i tij. Nëse Kontraktuesi refuzon, ai do të komunikojë pikëpamjet e tij ndaj Autoritetit Kontraktues në afat prej 15 ditësh pas datës në të cilën janë regjistruar të dhënat apo deklaratat kundërshtuese. Nëse Kontraktuesi dështon që të nënshkruajë ose të paraqesë pikëpamjet e tij brenda periudhës së lejuar, do të konsiderohet se Kontraktuesi pajtohet me shënimet e paraqitura në regjistër. Kontraktuesi mund të shqyrtojë regjistrin e punës në çdo kohë dhe mund, pa hequr dokumentin, të bëjë ose të marrë një kopje të shënimeve të cilat ai i konsideron të nevojshme për informacionin e tij.

20.3 Sipas kërkesës, Kontraktuesi do ta sigurojë Autoritetin Kontraktues me informacionin e duhur për të mbajtur regjistrin e punës në mënyrën e duhur.

### **Neni 21 Origjina dhe cilësia e punimeve dhe materialeve**

21.1 Punët, komponentët dhe materialet do të jenë në përputhje me specifikimet, vizatimet, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë dhe do të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë gjithë periudhës së realizimit.

21.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare do të jenë objekt i një kërkesë të dërguar nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues. Kërkesa duhet të referohet numrit të kontratës, numrin e Lotit dhe vendin ku do të zhvillohet pranimi i tillë, sipas rastit. Komponentët dhe materialet e specifikuar në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në pune.

21.3 Edhe nëse janë pranuar teknikisht materialet apo artikujt që do të përfshihen në pune ose në prodhimin e komponentëve, ato mund të refuzohen dhe duhet të zëvendësohen menjëherë nga Kontraktuesi nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime. Kontraktuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikujt do të pranohen për inkorporim në pune vetëm nëse janë riparuar.

### **Neni 22 Inspektimi dhe testimi**

22.1 Autoriteti Kontraktues do të emëroj "Menaxherin e Projektit", të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

22.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rëna dakord.

22.3 Kontraktuesi do të sigurojë që komponentët dhe materialet të dorëzohen në kohë në vend për të lejuar autoritetit kontraktues që të vazhdojë me pranimin e komponentëve dhe materialeve. Kontraktuesi konsiderohet se ka vlerësuar plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe nuk do të lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë në përbushjen e detyrave.

22.4 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë, ose nga vetë ose agjentit e tij, që të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë progresin e përgatitjes, fabrikimit apo



prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për ofrimin e sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojnë nëse komponentët, materialet dhe mjeshëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vend-punishite ose në ndonjë vend tjetër, siç mund të specifikohet në kontratë.

22.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet, Autoriteti kontraktues do ta njoftojë Kontraktuesin ose do të miratojë certifikimin e procedurës lidhur me këtë.

22.6 Nëse Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do të japë një deklaratë për pikëpamjet e tij ndaj tjetrit brenda 15 ditëve pas ngritjes së mosmarrëveshjes së tillë. Autoriteti kontraktues ose Kontraktuesi mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, nga një ekspert që zgjidhet me pëlqimin e përbashkët. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë të Kontraktuesi. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e të cilit dëshmohet se është gabim nga ri-testimit.

### **Neni 23 Paralajmërim i hershëm**

23.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vonë në kualitetin e punëve.

23.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato në skica apo në specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitohet menjëherë dhe do t'i konsideroj pasojat.

23.3 Nëse palët në kontratë vlerësojnë se ndërrimet substanciale të punëve janë bërë të nevojshme për shkak të gabimeve të tilla ose të përjashtimeve të cilat substancialisht ndikojnë në çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do të korrigjojë dhe kompensojë situatën sipas Ligjit të Prokurimit Publik.

### **PAGESAT**

#### **Neni 24 Pagesa**

24.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

24.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do t'i paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

24.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhet nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

24.4 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

#### **Neni 25 Paramasa dhe Parallogaria**

25.1 Paramasa dhe parallogaria duhet të përmbajnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve që duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe parallogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Parallogarisë për çdo artikull.

25.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmbajë aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregoj shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

#### **Neni 26 Parapagimi**

26.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë të

pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe vlerë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

26.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmojë se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

26.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

#### **Neni 27 Mbajtja e Parasë**

27.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim të tërë të Punëve. Kjo shume në asnjë rast nuk do të tejkalojë 10% e vlerës totale të kontratës origjinale. Kontraktuesi mund të zëvendësojë paratë të mbajtura me garancion bankar "me kërkesë".

27.2 Shuma e mbajtur ose garancia e mbajtjes do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29.

#### **Neni 28 Vërtetimet e pagesës**

28.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

28.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

28.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

28.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- a) Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Parallogarisë, vlerën e sasisë së punës në Paramasë dhe Parallogari që është përfunduar; ose
- b) Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëjë vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

28.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

#### **Neni 29 Llogaritja përfundimtare**

29.1 Kontraktuesi jo më vonë se 90 ditë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, do të dorëzojë tek Menaxheri i Projektit një draft të deklaratës së llogarisë përfundimtare me dokumentet mbështetëse që tregojnë në detaje vlerën e punës së bërë në përputhje me kontratën, së bashku me të gjitha shumat e mëtejshme të cilën Kontraktuesi konsideron se duhet paguar sipas kontratës, në mënyrë që Menaxheri i Projektit të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare.

29.2 Brenda 30 ditëve pas pranimit të draft-deklaratës së llogarisë përfundimtare dhe të gjithë informacionit të kërkuar në mënyrë të arsyeshme për verifikimin e saj, Menaxheri i Projektit do të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare, e cila përcakton:

- a) Shumën e cila sipas opinionit të tij duhet t'i paguhet sipas kontratës; dhe
- b) pas evidentimit të shumave të paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të cilat i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kontratës, bilanci, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, siç mund të jete rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumën përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.



### **Neni 30 Shkaqet për kompensim**

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

### **PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET**

#### **Neni 31 Parimet e përgjithshme**

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

#### **Neni 32 Testet për përfundimin**

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara ne shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

#### **Neni 33 Pranimi i përkohshëm**

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkritazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

#### **Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet**

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

#### **Neni 35 Pranimi përfundimtar**

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektit dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parcalizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

### **SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA**

#### **Neni 36 Shkelja e kontratës**

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:



- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

### **Neni 37 Shkëputja e kontratës**

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrimi;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrëgjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrëgjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

### **Neni 38 Forca madhore**

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2. Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcaktojnë Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcaktojnë Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

### **Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riadhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

### **Neni 40 Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

### **Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbyshja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

## **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

### **Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

### **Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrim në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimin.



# KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: KM653-24-1149-5-2-1/C535

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <b>Gjuha Shqipe</b>
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është <b>19,700.01€ me kohëzgjatje deri me date 26.09.2024</b> <b>Nr.polices 08978 Eurosig</b>
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve [shëno shumat]; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve [shëno shumat]; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën [shëno shumat]; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: [shëno shumat] (ii) të personave të tjerë: [shëno shumat]
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 2 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 2 ditë
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë <i>pas nënshkrimit të planit të muncës nga dy palet</i>
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 90 ditë kalendarike.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë.  Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Libri dhe ditari ndërtimor
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është <i>Vendim i ZKA-se</i>
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: <i>N/A</i>
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: Pas përfundimit të projektit punckryesi është i oboguar që ta dorëzojë Sigurimin e eliminimit të defekteve me kohëzgjatje prej 365

		ditë pas pranimit të punëve .
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 2 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periodha garantuese e defekteve është 365 ditë
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	<b>Zgjidhja miqësjdhja miqësore e mosmarrëveshjeve do të bëhet në mes të AK dhe Operatorit ekonomik</b>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.</p> <p>ose</p> <p>b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>



## Pjesa -II-Përshkrimi i çmimeve

LIDHJA E FSHATRAVE TË KOMUNËS SË KAMENICËS ME FSHATRA TË KOMUNËS SË NOVOBËRDËS PËRMES NDËRTIMIT TË SHTEGUT TË BICIKLISTËVE

**"LUGU I VERDHË"**

**A** "LIDHJA E FSHATRAVE TË KOMUNËS SË KAMENICËS ME FSHATRA TË KOMUNËS SË NOVOBËRDËS PËRMES NDËRTIMIT TË SHTEGUT TË BICIKLISTËVE"

Ne çmimi duhet të përfshihet mobilizimi i ndërmarrjes për fillimin e punimeve në projekt si dhe rregullimi i punishtes për punë dhe largimi i të gjitha llojeve të instalimeve në punishtë në rast se ka në ato hapësira. Gjithashtu të parashihet të vendoset edhe tabela informuese e cila duhet të përmbajë informata mbi projektin i cili ekzekutohet, duhet të jetë prezente gjatë gjithë kohës të ekzekutimit të punimeve të projektit. Në çmim të përfshihet edhe furnizimi i materialeve, instalimi dhe sjellja e produktit në gjendje funksionale. Të gjitha produktet duhet të jenë kualitative dhe ofertuesi në ofertën e tij duhet të përfshijë certifikatat e kualitetit dhe të standardeve si dhe broshurat apo katalogjet e produkteve me të dhënat teknike të produktit me të cilat merret pjesë në tender. Kontrollimi dhe evidentimi i instalimeve nëntokësore, zgjedhja e problemeve eventuale që lindin me planin operativ të ndërtimit si dhe përfillimi i planit detaj operativ që lidhet me procesin e ndërtimit. Në çmim të përfshihet edhe kosto eventuale e detektimit me anuarat ura elektronike për instalime nëntokësore si dhe evidentimi i saktë i instalimeve që duhet të mirëmbahen gjatë kohës së ndërtimit dhe në rast demblimit të bëhet riparimi i tyre (rrepi elektrik, rrepi i ujësjetës etj) dhe infrastruktura mbështetëse.

1	PROJEKTI I RRUGËS					
1.1	INÇIZIMET DHE PUNET PARAPRAKË NE TEREN					
Nr.	POZICIONI	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (€)	Vlera totale me TVSH(€)	
1.1.3	Pastrimi i terrenit nga objektet ekzistuese nga dy anet e rrugës si: prenja dhe largimi i drunjëve, shkurrave dhe materialeve tjera të cilat janë në trupin e rrugës për ndërtim dhe bartja e tyre në një depo në ku e caktan organin përgjegjës i punishtes.	Paushall	1.00	200.00	200.00	
1.1.4	Sigurimi i punishtes nga hyrjet anesore të automjeteve. Sigurimi të bëhet përmes shenjave perkatëse të cilat krijojnë siguri dhe zhvillim normal të punimeve në gjithë orarin sipas kërkesave të investitorit.	Paushall	1.00	198.00	198.00	
<b>TOTALI:1.1</b>						<b>398.00</b>
1.2	PUNET NDERTIMORE NE SEKSIONIN E RRUGES					
Nr.	POZICIONI	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (€)	Vlera totale me TVSH(€)	
1.2.1	Furnizimi dhe punimi i shtresës së Bitoagregatit 0-16mm me trashësi t=8 cm' në gjendje të ngjeshur. Duke përfshirë grryerjen e asfaltit ekzistues ngjeshjen, rrafshimin e shtresave ekzistuese të zhavorit, sperkatjen me emulsion 0.2 kg/m <sup>2</sup> Në çmim të kalkulohen edhe testet marshall sipas standardeve për këtë pozicion. <i>Riparim i rrugës së vjetër</i>	m <sup>2</sup>	50.00	14.00	700.00	
1.2.2	Furnizimi dhe punimi i TROTUARIT shtresës së Bitoagregatit 0-16mm me trashësi t=6 cm' në gjendje të ngjeshur. Në çmim të kalkulohen edhe testet marshall sipas standardeve për këtë pozicion. Gjerësia e trotuarit është 1.2m' -1.5m'	m <sup>2</sup>	1350.00	9.30	12,555.00	
1.2.3	Furnizimi dhe montimi i skajoreve në TROTUAR me dim 18/24cm nga betoni. Në çmim të përfshihet edhe betonimi për montimin dhe fiksimin e skajoreve. Rregullimi/përmirësimi si dhe evidentimi i skajoreve të demtuara, kjo të bëhet në bashkëpunim me Menaxherin e kontratës.	m'	100.00	17.00	1,700.00	
1.2.4	Furnizimi dhe montimi i skajoreve në TROTUAR me dim.8/20cm nga betoni. Në çmim të përfshihet edhe betonimi për montimin dhe fiksimin e skajoreve.	m'	100.00	14.00	1,400.00	
<b>TOTALI:1.2</b>						<b>16,355.00</b>



1.3 PUNET E MUREVE MBROJTESE						
MURET MBROJTESE "L" NGA BETON-ARMEJA						
		Gjatesia e murit (m)	42			
		Lartesia e murit (m)	3			
		Trashësia e murit (m)	0.25			
		Gjerësia e bazës (m)	1.75			
		Trashësia e bazës (m)	0.4			
		Diametri i armaturave Ø (mm)	10			
		Pesha e fijeve te armaturave Ø 10 (kg/m)	0.617			
		Distanca e fijeve te rrjetes (m)	0.15			
Nr.	POZICIONI	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (€)	Vlera totale me TVSH(€)	
1.1	Gërmimi i dheut te kategorisë III-V, duke përfshirë edhe humusin, deponimi i tij deri ne 50m ne afersi te punishtes (sepse nje pjese e tij do te rikthehet mbrapa murit).	m <sup>3</sup>	255.50	5.00	€	1,277.50
1.2	Furnizimi dhe vendosja e tamponit nen themele me zhavor Ø 31.5, me t=20cm dhe ngjeshja e tij me vibroplake.	m <sup>3</sup>	14.00	16.00	€	224.00
1.3	Furnizimi, shtrirja dhe rrafshimi i betonit te varfer me t=5cm nen pllaken e themelit. Klasa e betonit C16/20	m <sup>3</sup>	3.68	60.00	€	220.80
1.4	Furnizimi me armature, pastrimi nga pluhuri dhe ndryshku, prerja dhe lakimi i saj. Armatura te punohet rrjete me shufra me diameter Ø10 çdo 15/15cm, ku çdo maje e shufrave duhet te kthehet 90 shkalle 20 cm edhe nje here 90 shkalle 5cm. Vazhdimet e armaturave te mos jene me te shkurtra se 1m. Çeliku për armature do të aplikohet në përputhje të plotë me normat ENV 10080 si dhe të posedon me karakteristikat që vijojne:Vlera karakteristike e kufirit të rrjedhjes (yield strength characteristic value) fyk=500 N/mm2 Madhësitë e diametrit të përputhen me vlerat nominale sipas ENV 10080 Furnizimi, prerja, lakimi dhe montimi i shufrave të armaturave duhet të bëhet sipas formave të paraqitura në detalet teknike si dhe të verifikohen në vendpunishte. Klasa e duktilitetit (ductility class) B e lartë (high ductility) B 500 B.	kg	5,067.65	1.00	€	5,067.65
1.5	Furnizimi dhe vendosja e betonit per muret mbajtese nga bet.arm. C25/30 sipas llogarise statike. Te përfshihet edhe punimi shallonave elastike nga llamarina, per rezultat me te mire te siperfaqes se betonit, me distanca sipas nevojës. Fugat e dilatimit te punohen nga listelat kendoret nga druri ,çdo 6m te murit.	m <sup>3</sup>	58.00	90.00	€	5,220.00
1.6	Furnizimi dhe vendosja e gypave per drenazhim Ø 110, duke përfshirë edhe pjeset shtese te gypit per shkarkim.	m	42.00	6.00	€	252.00
1.7	Furnizimi dhe vendosja e gjeotekstilit 150gr/m2, mbi gypat e drenazhes, para se te mbulohen me zhavor.	m <sup>2</sup>	40.00	3.00	€	120.00
1.8	Furnizimi dhe punimi me zhavor me granulat 16-31.5 per drenazhim pas murit mbrojtës me trashesi prej t=40 cm	m <sup>3</sup>	28.00	12.00	€	336.00
1.9	Kthimi i dheut te germuar më parë, dhe mbushja mbrapa murit me ngjeshje graduale te shtresave çdo 30cm, mbi shtresen e zhavorit te drenazhes, ndersa dheu i teper te ngarkohet dhe bartet deri në deponi në largësi max 15km.	m <sup>3</sup>	151.83	5.00	€	759.15
	Muri me guri te perpunuar me dore, forma e gureve dhe fugat natyrale, lartesia te behet sipas terrenit ekzistues rreth 2.5m, fugat nga llaqi i cementos, ne çmim te llogaritit themeli shiritor nga betoni C25/30, i armuar me 6 shufra Ø12, me stafat Ø8 çdo 15cm h/h 55/40, te pergatitet kurora prej beoni c25/30 i armuar me 4 shufra Ø10 dhe me stafa Ø8 h/h-30/30 cm.	m <sup>3</sup>	22.00	70.00	€	1,540.00
<b>TOTALI:1.3</b>						<b>15,017.10</b>





1.4	<b>PUNET E QENDRAVE TE PIKNIKUT</b>					
1.4.1	Piketimi dhe pastrimi i sipërfaqes së parapare për ndërtimin e objekteve, materiali i grumbulluar largohet në deponi të autorizuar.	m <sup>2</sup>	350.00	2.00	€	1,100.00
	Furnizimi dhe montimi i vendzjarrit në ambient të jashtëm, germimi i dheut me t=15 cm në form rrethore me diametër 150cm', mbushja me zhavor 0-32mm në trashësi 10cm, furnizimi dhe montimi i enes në forme cilindri prej metali me t=2mm' me lartësi 50cm' me diametër 100cm, muratimi rrethor me gure natyral me t=25cm' dhe lartësi 50cm', si dhe punimi i kurorës nga betoni i armuar me rrjet fi-8mm' çdo 15/15cm, të ilustruar e gjëni në përshkrim teknik.	cope	6.00	1,000.00	€	6,000.00
	Furnizimi punimi dhe montimi u uleseve dhe tavolines nga druri i pishës në mex të verandave ekzistuese, ulesja të jete për 10 persona, forma e ulesës dhe dimensionet të jete si në përshkrim teknik	cope	4.00	3,000.00	€	12,000.00
1.4.2	Furnizimi transporti, montimi i skajoreve përgjate perimetrit të kubezave të vendosura në PUSHIMORET, me dim3/20cm nga betoni, në cmim të parashihet edhe betonimi për montimin e fiksimit e skajoreve. Në cmim të llogaritet dhe cmontimi dhe montimi i kubezave ekzistuese, si dhe materialin e nevojshëm	m'	320.00	13.00	€	4,160.00
1.4.3	Pastrimi i terrenit me makine dhe germimi i dheut sipërfaqësor në trashësi deri në 30 cm' apo me shume për kendin e lojes, mbushja dhe ngjeshja me zhavor 0.63 shtresa e pare me trashësi 15 cm dhe me zhavor 0.32mm mbushja dhe ngjeshja në trashësi 15 cm', sipërfaqeja e llogaritur me m <sup>2</sup> Betonimi i bazave nga betoni i armuar për ankerim të rekuizitave sipas përshkrimit të nevojshëm për to. Lokacioni sipas përshkrimit teknik.	m <sup>2</sup>	250.00	25.00	€	6,250.00
1.4.4	Furnizimi, punimi dhe montimi i Rekuizites Shtepi për loje nga druri, sipas përshkrimit teknik me nr. PH - 07 Dru i impregnuar me diametër 100mm dhe gjatësi 2000mm, Konstrukione metalike me diametër Ø32 mm të gjitha duhet të jete galvanizuara, Plywood 21mm, Produkti është i mbrojtur dhe i trajtuar me ngjyrë Poliesteri në temperaturë + 180 grad celzius, Ankerimi të behet me elemente metalike të forcuara me beton të parafabrikuar, Topogani spiral Hdpe, Saldimet janë bërë dhe testuar sipas standardeve Europiane : ISO 9606-1, Prodhiimi dhe instalimi i pajisjes duhet të behet sipas norms evropiane EN -11 76, Elemente nga konstrukcioni metalik me diametër 114 mm dhe trashësi 3 mm.	cope	1.00	2,500.00	€	2,500.00
1.4.5	Furnizimi, punimi dhe montimi i Rekuizites Balancim, sipas përshkrimit teknik me nr. BA - 02, Material i përdorur dru masivë i impregnuar me diametër 14 cm dhe gjatësi 300 cm, Konstrukionet lidhëse prej Metali janë të Galvanizuara, Shtylla lidhëse të konstrukcionit janë prej drurit masivë me diametër 12 cm të cilët e kanë edhe një mbulesë nga plastike në kokë të shtyllës, Ankerimi behet direkt në vendpunishite dhe duhet bërë betonimin, Saldimet janë bërë dhe testuar sipas standardeve Europiane : ISO 9606-1, Prodhiimi dhe instalimi i pajisjes duhet të behet sipas norms evropiane EN -11 76.	cope	1.00	5,500.00	€	5,500.00
1.4.6	Furnizimi, punimi dhe montimi i Lish-arese, sipas përshkrimit teknik me nr. SW - 06 Elemente nga konstrukcioni druri me diametër 120 mm Ankerimi të behet me elemente metalike të forcuara me beton të parafabrikuar, Pjesa ku ulen fëmijët është pllakë nga Goma me trashësi prej 30 mm, Saldimet janë bërë dhe testuar sipas standardeve Europiane : ISO 9606-1, Prodhiimi dhe instalimi i pajisjes duhet të behet sipas norms evropiane EN -11 76, Druri duhet të jete i certifikuar nga organizata ndërkombetare e pyjeve FSC-STD-40-004.	cope	1.00	3,000.00	€	3,000.00



1.4.7	Furnizimi, punimi dhe montimi i Lisharese, sipas pershkrimit teknik me nr. SW - 07 Elemente nga konstrukcioni metalik me diameter 76 mm dhe trashësi 3 mm Produkti është i mbrojtur dhe i trajtuar me ngjyrë Poliesteri në temperaturë + 180 grad celzius, Ankerimi te behet me elemente metalike te forcuar me beton te parafabrikuar, Pjesa ku ulen fëmijët është pllakë nga Goma me trashësi prej 30 mm, Saldimet janë bërë dhe testuar sipas standardeve Europiane : ISO 9606-1, Prodhimin dhe instalimin i pajisjes duhet te behet sipas norms evropiane EN -11 76, Druri duhet te jete i certifikuar nga organizata nderkombetare e pyjeve FSC-STD-40-004.	copë	1.00	3,500.00	€	3,500.00
1.4.8	Furnizimi, punimi dhe montimi i Paisje per leshim , sipas pershkrimit teknik me nr. CL - 13 Dru i impregnuar me diameter 120mm dhe gjatesi 3000mm Ankerimi te behet me elemente metalike te forcuar me beton te parafabrikuar, Litar me fije qeliku trashësi 18mm të galvanizuara, Pjesët tjera lidhëse të produktit janë të punuara nga metali dhe po ashtu të galvanizuara, Saldimet janë bërë dhe testuar sipas standardeve Europiane : ISO 9606-1, Prodhimin dhe instalimin i pajisjes duhet te behet sipas norms evropiane EN -11 76, Druri duhet te jete i certifikuar nga organizata nderkombetare e pyjeve FSC-STD-40 004, V3-0	copë	1.00	5,500.00	€	5,500.00
1.4.9	Furnizimi, punimi dhe montimi i Ulese, sipas pershkrimit teknik me nr. PF - 16, Ujësjë e Parukt e punuar me konstrukcion nga metali dhe Druri, Konstrukcioni i këmbëve është prej Metalli me dimensione 40x40 mm të Galvanizuara, Pjesa për ulje është nga druri i klazit të parë ( Bredhë ) me lagështi rrethë 12% i mbrojtur me tri shtresa ngjyre, Pjesa për ulje përbëhet nga 1 elemente të drurit me dimensione 120 x1500 mm, Pjesa e mbeshetese përbëhet nga 1 elemente të drurit me dimensione 120 x1500 mm, Montimi i elementëve të drurit duhet te bëhet me bulona Torban M8 X 70 mm, Ankerimi bëhet në katër këmbët e Uleses me tiplla M10 X 100 mm, Saldimet janë bërë dhe testuar sipas standardeve Europiane : ISO 9606-1, Prodhimin dhe instalimin i pajisjes duhet te behet sipas norms evropiane S SH EN - 11 76, Druri duhet te jete i certifikuar nga organizata nderkombetare e pyjeve FSC-STD-40-004, V3-0.	copë	3.00	1,500.00	€	4,500.00
1.4.10	Furnizimi transporti si dhe punimi i dyshemese se shetitores skaj liqenit (te ilustruar e gjenii ne pershkrim teknik), nga materiali i drasave (fosne me trashësi mbi 4cm <sup>2</sup> ) adekuate per perdorim te jashtem, te flogaritet konstrukcioni shtyllat , shtangimet dhe mbajtësit horizontal gjatevor, nga druri me trashësi se paku Ø150mm, me distance te shtyllave nga njera tjetra max 2m <sup>2</sup> nga njera tjetra, shtyllat te nguliten ne toke se paku 100cm, niveli maksimal i drasave te dyshemese te jete i ngritur 50cm mbi kuoten kaperdërdhese te pendes, te flogaritet ljerja e shtyllave dhe trajeve me mbrojtje kunder lagashtise (izolimi me bitumen apo te ngjashem te shkurre ne pjesen qe futen nen dheun dhe nen tje) i shtyllave para se te nguliten ne toke, te flogariten edhe te gjitha materialet tjera te nevojshme (kangjat, kilanfat, gozhda te gjata per konstrukcione te drurit etj) per kompletimin e pozicionit, Shih detajet	m <sup>2</sup>	528.00	30.00	€	15,840.00





1.4.11	Furnizimi, transporti dhe punimi i gardhit prej druri pergjate murit prej gureve, me shtylla vertikale prej druri deri ne lartesi 1m' cdo 2m' dhe me shtylla diagonale ne form te 'x', lidhja e tyre dhe shtangimi te behet me ankerim prej metali. Te gjitha shtyllat te jene me trashesi fi 100-120 mm, si dhe punimi i elementeve per ankerim ne beton ekzistues, duke perfshire kembet nga pllakat e qelikut te galvanizuar (zinkim ne te nzehte), me dimensione te pllakes horizontale 150x150x5mm, si dhe pllakes vertikale (qe saldohet me pllaken horizontale) me dimensione 100x200x5mm, 4 ankerave M12 L150, si dhe 3 Bulonat me dado dhe filete M12 L150.	m'	100.00	70.00	C	7,000.00
1.4.11	Furnizimi me material dhe punimi i depos-parkingut te bicikletave, nga konstruksioni i drurit te pishes, lartesia e strehes se paku 2.4m nga kubezat, konstruksioni me dimensione te prerjes terthore 9x11cm, kulmi me pjerrtessi 25-30 shkalle, dyshemeja e kulmit drrasa (patos) me goja, listelat dhe kontralistelat 2.5x4.5cm, stiropor 2cm dhe folia difuzive, ndersa mbulesa me llamarine te plastifikuar ngjyre te kuqe. Mveshja anesore e parkingut te behet me listela 4.5x2.5cm, duke e lene nga nje hapesire te zbrazet ndermjet listelave, te cilat montohen horizontal. Depo duhet te jete me dimensione te mbrendeshme 4.5x5.5m. Streha te llogaritet 50 cm e dalur nga te 4 anet. Te llogaritet punimi i 2 dyerve nga konstruksioni i drurit 5x7cm dhe mveshja me listela 4.5x2.5cm, me bravat, me ilinder me 3 qelesa dhe nga 3 mentesha per derë, te llogariten ulluket horizontal dhe 2 ulluqe vertikale. Shtyllat ankerohen ne gypa qeliku se paku 50 cm ne beton, Komplet puna dhe materiali per copë. Ne qmim te perfshihet edhe pergatitja e bazes me zhavor 0-30 me trashesi prej 15 cm dhe pergatitja e bazes me beton te armuar c25/30 me trashesi 15 cm' Shih detajet	cope	1.00	4,000.00	C	4,000.00
1.4.12	Furnizimi, transporti si dhe montimi i ndriqesve solar, me specifikat si ne vazhdim, Ndriquesi LED, Lighting Color White, IP65, Color Temperature 6000-6500k. Te llogaritet edhe shtylla metalike me lartesi 4m, e ngjyrosur me baze dhe ngjyre, e lidhur me pllake qeliku 25x25cm, me t=5mm, e cila ankerohet permes armaturave ne bazament nga betoni me dimensione 100x50x50cm. Te kene sensorin e drites dhe pajisjet per 'dimming', ashtu qe te mund te rregullohet periudha kur ndriquesi punon me kapacitet minimal dhe me ate maksimal.	cope	15.00	550.00	C	8,250.00
1.4.13	Furnizimi, transporti si dhe montimi i urave te vogla nga druri, e pershtatshme per ecje dhe qiklizem, gjeresia e paster se paku 1.5m, gjatesia 2-3m. Dyshemeja te jete e rrafshuar mire dhe lehte e kalueshme. Ne qmim te llogaritet edhe kribet e ures te punuar nga guri i muratur, i vendosur ne themele nga betoni, pjesa e dukshme e ures te jete nga guri dhe druri. Te llogaritet dyshemeja me drrasa me trashesi se paku 3.5cm, gardhi me dru me trashesi se paku Ø60mm, konstruksioni shtyllat dhe shtangimet me trashesi se paku Ø100mm, ndersa mbajttest horizontal gjatesor me trashesi se paku Ø200mm. Shih detajin	cope	3.00	1,000.00	C	1,000.00
TOTALI:1.4						92,100.00



1.5	<b>PUNET E TERENIT SPORTIV/AMFITEATRI</b>					
1.5.1	Pastrimi i amfiteatrit pjesen e fushes dhe shkallet e Amfiteatrit, pergatitja e venpunishtes per pune.	Pastrhall	1.00	150.00	€	150.00
1.5.2	Furnizimi montimi dhe transporti i gjithe materialit te nevojshem per betonimin e shaklleve/tribunave te Amfiteatrit, Betoni c-25/30, armatura rrjete fib cdo 15/15 cm. Te behet kallopimi me tabela nga metali i lenuar, per arsye qe finalizimi te jete i paster dhe siperfaqja e betonit te jete e lenueshme dhe lakore e pastert estetike, trashesia e betonit qe ka te beje me mveshjen e shaklleve te jete 12cm <sup>3</sup> , kendet ndermjet horizontales dhe vertikales te jene te thyera 45 shkalle (me listela kondore), Ulogaria behet me m3.	m <sup>3</sup>	21.00	150.00	€	1,150.00
1.5.3	Betonimi i shkalleve dhe pjerrines rreth 6% per qasje ne amfiteater prej betoni te armuar c-25/30, pjesa e armatuar sipas detalit, ne cmim te parashihen dhe pahit e nevojshme, shallonat te punohen me tabela prej metali - finalizimi te jete me teksture te paster, llogaria me m <sup>3</sup> . Bazamakot te jene 30-32cm dhe lartesia e shkalleve te jene 16-17cm. Pjerrina te kete gjersien se paku 100cm, te fillohet ne njeren ane dhe te perfundoj ne anen tjeter te shkalleve, pra kalon neper mes shkalleve, shiko prancimin dhe formen ne perskrim teknik.	m <sup>3</sup>	10.00	110.00	€	1,100.00
1.5.4	Furnizimi dhe vendosja e fer Betonit 12cm <sup>3</sup> beton c30/37 sipas projektit ne pjesen e Amfiteatrit, rrafshimi te behet me precizitet te larte ne betonin gjysem te thare dhe me makine speciale/helikopter, gjate rrafshimit te hidhet cimento pluhur deri ne lustrim final.	m <sup>2</sup>	405.00	25.00	€	10,125.00
1.5.6	Furnizimi dhe montimi i tabelës së basketbollit PROFESIONAL, me te gjitha paisjet e nevojshme. Konstruksioni metalik, ne cmim duhet te perfishihet ankerimi, rrjeta dhe te gjitha elementet e nevojshme qe e kompletone kete pozicion dhe e bejne funksional. Dimensionet dhe specifikat jane te paraqitura ne perskrim teknik.	cope	1.00	500.00	€	500.00
1.5.7	Furnizimi me material si dhe ngjrosja e siperfaqes se fushes dhe vijave te Amfiteatrit me ngjyra te ndryshme per ambiente te jashtme per dysheme te fushes se basketbollit. Pozicioni perfishine te gjitha materialet dhe punet e nevojshme qe ky aktivitet te jete funksional, te gjitha materialet duhet ti plotesojne standardet teknike evropiane te parapara per keto aktivitet. Te ngjyroset muri vertikal, dizajni sipas projektit apo sipas kerkeses se A.K, garancioni te jete mbi 5 vjecar.	m <sup>2</sup>	310.00	10.00	€	1,100.00
<b>TOTALI:1.5</b>						<b>18,125.00</b>
1.6	<b>PUNET E PARKINGUT I DHE II DHE RRUGEVE TE ZIPPLUNIT ME ZHAVOR</b>					
1.6.1	Pastrimi i terenit nga objektet ekzistuese, si: prerja dhe lompimi i drunjeve, shkurrave dhe materialeve tjera te cilat jane ne pjesen per nderim dhe bartja e tyre ne nje deponi ku e cakton organi pergjegjes i punshites. Lokacioni sipas perskrimit teknik.	m <sup>2</sup>	5,300.00	1.00	€	5,300.00
1.6.2	Germimi i dheut i kategorise III-IV duke perfunduar ngarkim dhe bartje deri ne deponi te caktuar, thellesia mesatare t=0.5 m <sup>3</sup> ngjeshja e nenbazes sipas gruyerjes deri ne Mv >40MN/ m <sup>2</sup> (Parkingjet e reja)	m <sup>3</sup>	1,780.00	5.00	€	8,900.00
1.6.2	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit te thyer gjeqeror fr. 0-150mm me trashesi t=30cm, ngjeshmeri e kerkuar Mv> 50 MN/m <sup>2</sup> . (Parkingjet e reja)	m <sup>3</sup>	1,068.00	10.00	€	10,680.00
1.6.3	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit te thyer gjeqeror fr. 0-63mm me trashesi t=20cm, ngjeshmeri e kerkuar Mv> 60 MN/m <sup>2</sup> . (Parkingjet e reja dhe rruget e zipplinit)	m <sup>3</sup>	1,060.00	12.00	€	12,720.00
1.6.4	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit te thyer gjeqeror fr. 0-31.5mm me trashesi t=10cm, ngjeshmeri e kerkuar Mv> 70 MN/m <sup>2</sup> . (Parkingjet e reja dhe rruget e zipplinit)	m <sup>3</sup>	530.00	16.00	€	8,480.00
<b>TOTALI:1.6</b>						<b>46,080.00</b>





1.7 TABELAT INFORMUESE/ORIENTUESE							
1.7.1	Furnizimi me material, punimi dhe montimi i Shtyllave metalike - gjatesia e shtylles 270 cm - diametri i shtylles se paku 5 cm - trashesia 2mm - thellesia ne grope 50 cm, gjersia e gropes 50 cma50cm, 50 cm me beton, ngjeshje adekuatë per shtangim, ne fund te shtylles te saldohet nje metal (shufer ter(hore) 20 cm, qe nuk e lejon te levize shtylla, si ne foto. Materiali i shtylles qelik i galvanizuar apo i zinkuar ne te nxehste. Ne cmim te llogariten edhe bulonat dhe shtangueset metalike per lidhjen e tabelave ne shtylla. Si ne pershkrim teknik.	cope	25.00	33.00	€	825.00	
1.7.2	Furnizimi me material, punimi dhe montimi i Tabelave orientuese, material alukobond (rezistenc ndaj korezionit) plus folie fluroshete. -dimenzionet: gjatesia 55 cm, - lartesia 15 cm, - trashesia 4 mm - ngjyra e tables te jete e verdh - emertimi i tables orientuse psh, me nje rresht, dy ose tre rreshta, tekstin e cakton A.K. Modeli i tabelave orientuese si ne pershkrim teknik.	cope	20.00	30.00	€	600.00	
1.7.3	Furnizimi me material, punimi dhe montimi i Tabelave te zones (Drejtkendore) - Gjatesia 45 cm - Lartesia 15 cm - Trashesia 4mm alukobond, - Ngjyra e tableve te jete e verdh - Emertimi i tabes te zones psh, me nje rresht, dy ose tre rreshta, tekstin e cakton A.K. Modeli i tabelave te zones si ne pershkrim teknik	cope	20.00	25.00	€	500.00	
1.7.4	Furnizimi me material dhe punimi dhe montimi i Portes hyrese qe vendoset ne fillim te shtegut (Lagjes se Gajtanevet, numeron nga drumi me nallt, lloj rezistent ndaj kalbezimit lloji Bung. Elementet e konstruksionit te jene nga cime natyral (Lis) i gedhendur mire nga levorja deri ne krijim te formes se pasiert, me diameter se paku Ø40cm. Lartesia e shtyllave te jete h=600cm (500 imbi toke dhe 100 ne beton) Drrasa per shenime te jete e gjate 300cm, me lartesi te ndryshueshme (n. fytyre) se paku 50cm dhe maksimum 60cm, trashesia 5cm, me tekst te gravor (lugu i verdhe - Green Veally), dizajni i shkronjave percaktohet nga A.K. Lidhja e drrases me shtyllat behet ne forme te varjes, pormes litarit natyral me trashesi se paku 2cm dhe gjatesi se paku 10m, ne drrasen e va ur te montohen unazat e qeliktat Ø12mm, te cilat lidhen ne drrase pormes vjeteve, neper te cilat deperton litari, litari lidhet dhe shtangohet mire me nje. Te llogaritet ankerimi i shtyllave ne themele te betonit (25/30), me dimensione 100x100x100cm, duke perfshi betonin, armaturen "kosh" rrjete Ø10 çm 20/20cm ne te gjitha anet, gerrimin 120x100x100, zhavorin 0-31.5, me t=20cm me ngjeshje, si dhe te gjitha elementet deri ne funksionalim te pozicionit. Dheu i tepert te largohet deri ne deponi.	cope	1.00	6,500.00	€	6,500.00	
1.7.5	Ngjyrosja e shenjave orngjate shtigjeve ne sferfaqe te gureve ose drrajeve te gjalle, duke perdorur ngjyre adekuatë dhe model te shenjezimit si ne foto. Shenjezimi cdo 100-200 m <sup>2</sup> gjatesi, behet me ngjyre ne shabllonat e punuar si ne pershkrim teknik.	cope	25.00	20.00	€	500.00	
TOTALI: 1.7						8,925.00	

R-KAPITULIMI		
Nr.	Pershkrimi i pozicionit	Gjithsej
1.1	INÇIZIMET DHE PUNET PARAPRAKE NE TEREN	€ 398.00
1.2	PUNET NDERTIMORE NE SEKSIONIN E RRUGES	€ 16,355.00
1.3	PUNET E MUREVE MIBROJTESE	€ 15,017.10
1.4	PUNET E QENDRAVE TE PIKNIKUT	€ 92,100.00
1.5	PUNET E TERENIT SPORTIV	€ 18,125.00
1.6	PUNET E PARKINGUT I DHE II	€ 46,080.00
1.7	TABELAT INFORMUESE/ORINTUESE	€ 8,925.00
TOTALI + TVSH:		€ 197,000.10

